**AKTI THEMELIMI I**
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**"Entertajni" Sh.p.k**

Sot, më 19/09/2018, në Tiranë, palët si më poshtë (më poshtë quajtur bashkarisht si "**Palët**", ose vecmas si "**Pala**") bien dakord mbi këtë Akt Themelimi si vijon:

- **Z. Arben Mërtiri**, shtetas shqiptar, lindur më 14.02.1970, në Bubullimë, Lushnje, banues në Kolonjë, Lushnje, mbajtës i kartës së identitetit nr. 025511983, do të zoterojë 1 (një) kuotë të barabartë me 8,536,160 (tetë milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Lekë, dhe që përfaqëson 40% (dyzet për qind) të kapitalit të shoqërisë;

- **Z. Arben Nazëraj,** shtetas shqiptar, lindur më 12.11.1966, në Vreshtas, banues në adresën: Lagjia Kastriot, Rruga Anton Profka, Fier, mbajtës i kartës së identitetit nr. 033013327, do të zotërojë 1 (një) kuotë të barabartë me 4,268,080 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë) Lekë, dhe që përfaqëson 20% (njëzet për qind) të kapitalit të shoqërisë;

- **Z. Artan Zhupani**, shtetas shqiptar, lindur më 31.08.1971, në Gradishtë, Lushnje, banues në adresën: godina 32, Fier-Seman, Grabishtë, Divjakë, mbajtës i kartës së identitetit nr. 027601608, do të zoterojë 1 (një) kuotë të barabartë me 4,268,080 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë) Lekë, dhe që përfaqëson 20% (njëzet për qind) të kapitalit të shoqërisë; dhe

- **Z. Armando Dino,** shtetas shqiptar, lindur më 29.07.19?7, në Pojan, Fier, banues në Pojan, Fier, mbajtës i kartës së identitetit nr. 024645761, do të zotërojë 1 (një) kuotë të barabartë me 4,268,080 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë) Lekë, dhe që përfaqëson 20% (njëzet për qind) të kapitalit të shoqërisë.

## I. Themelimi

Palet deklarojnë themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"Entertajni" Sh.p.k.,** person juridik shqiptar, (referuar më poshtë si "**Shoqëria**"), bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar ("**Ligji Tregtar**").

## II. Selia

Shoqëria ka adresën e saj në: Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Perlat Rexhepi, Pallati Nr. 6, Ap. 3, Nr. Pasurie 4/73+1-4, Zona kadastrale Nr. 8270, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të hapë edhe zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vënde të tjera si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, sipas vendimit të Shoqërisë.

## III. Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

## IV.Objekti

Objekt i aktivitetit të Shoqërisë është ofrimi i shërbimit të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve audiovizive, në veçanti në fushën e transmetimeve televizive kabllore. Gjithashtu, Shoqëria do të veprojë për gjetjen dhe shtimin e klientëve për palë të treta duke promovuar dhe kryer marketing dhe sherbime të tjera të ngjashme në të gjitha format tregtare të ligjshme, në funksion të këtij qëllimi.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria mund:

i. të kryejë cdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie-marrje me qera, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër;
ii. të blejë në mënyrë direkte apo indirekte, kuota të shoqërive të tjera që kanë një objekt të përafërt me atë të Shoqërisë, në Shqipëri ose jashtë shtetit;
iii. të kryejë cdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishem ose i domosdoshëm për të arritur qëllimin e aktivitetit të saj.

Shoqëria duhet të kryejë cdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj, në lidhje dhe që e favorizon atë.

Shoqëria duhet të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse. Ajo përfshin standartet më të mira etike.

## V. Statuti

Palët deklarojnë se bien dakord për pajisjen e Shoqërisë me Statut, i cili është nënshkruar rregullisht nga Palët.

### VI. Kapitali Themeltar dhe Ortakët e Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë është i barabartë me vlerën 21,340,400.00 (njëzetë e një milion e treqind e dyzet mijë e katërqind) Lekë dhe është i ndarë në 4 (katër) kuota. Kontributi i ortakëve në Kapitalin themeltar të Shoqërisë do të jetë në natyrë sipas Raportit të Vlerësimit i datës 03.09.2018, bashkëlidhur Statutit.

Ortakët e Shoqërisë dhe kuotat përkatëse të tyre janë si më poshtë:

- **Z. Arben Mertiri**, shtetas shqiptar, lindur me 14.02.1970, ne Bubullime, Lushnje, banues në Kolonjë, Lushnje, mbajtës i kartës së identitetit nr. 025511983, do të zoterojë 1 (një) kuotë të barabartë me 8,536,160 (tetë milion e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Lekë, dhe që përfaqëson 40% (dyzet për qind) të kapitalit të Shoqërisë;

- **Z. Arben Nazëraj,** shtetas shqiptar, lindur më 12.11.1966, në Vreshtas, banues në adresën: Lagjia Kastriot, Rruga Anton Profka, Fier, mbajtës i kartës së identitetit nr. 033013327, do të zotërojë 1 (një) kuotë të barabartë me 4,268,080 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë) Lekë, dhe që përfaqëson 20% (njëzet për qind) të kapitalit të Shoqërisë,

- **Z. Artan Zhupani**, shtetas shqiptar, lindur më 31.08.1971, në Gradishtë, Lushnje, banues në adresën: godina 32, Fier-Seman, Grabishtë, Divjakë, mbajtës i kartës së identitetit nr. 027601608, do të zoterojë 1 (një) kuotë të barabartë me 4,268,080 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë) Lekë, dhe që përfaqëson 20% (njëzet për qind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe

- **Z. Armando Dimo,** shtetas shqiptar, lindur më 29.07.1977, në Pojan, Fier, banues në Pojan, Fier, mbajtës i kartës së identitetit nr. 024645761, do të zotërojë 1 (një) kuotë të barabartë me 4,268,080 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë) Lekë, dhe që përfaqëson 20% (njëzet për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme midis ortakëve dhe të tretëve në çdo moment.

Përgjegjësia e ortakëve për mbulimin personalisht të humbjeve të Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

### VII. Administratori

Administratori i Shoqërisë do të jetë Z. Arben Mërtiri, shtetas shqiptar, lindur më 14.02.1970, në Bubullimë, Lushnje, banues në Kolonjë, Lushnje, mbajtës i kartës së identitetit nr. 025511983.

Kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë të Administratorit është për një afat 5 (pesë) vjecar, me të drejtë ripërteritje të këtij mandati.

Akti i emërimit të Administratorit gjendet bashkëlidhur Aktit të Themelimit të shoqërisë.

*Ky akt themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në shqip dhe konsiderohet si mbledhja e parë e Asamblesë së Pergjithshme të ortakëve themelues të shoqërisë. Ky Akt Themelimi është hartuar sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.*

### ORTAKËT THEMELUES

**Arben Mërtiri**

**Arben Nazëraj**

**Artan Zhupani**

**Armando Dimo**